

VENDIM
Nr. 28/2021

**PËR EMËRIMIN E ZOTIT OLSI ÇOKU NË DETYRËN E ANËTARIT TË
BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, QË DO TË
MBAJË FUNKSIONIN E KRYETARIT TË BORDIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6 dhe 8 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Olsi Çoku emërohet anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e Kryetarit të Bordit për periudhën e mbetur të mandatit të anëtarit të liruar nga kjo detyrë. Periudha e mbetur e mandatit përfundon në datën 12.9.2024.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 8.3.2021.